Kronikë

# Tiranë/ Lëvizte i armatosur nëpër kryeqytet, pas arrestimit i gjendet dhe sasi droge! Arrestohet 40-vjeçari me dy identitetet (VIDEO)

*Policia e Tiranës finalizoi sot operacionin e koduar "Klienti", nga Sektori për Hetimin e Narkotikëve. Në pranga ra shtetasi H. Q. (G)., 40 vjeç. Sekuestrohet pistoleta dhe një sasi lëndë narkotike*

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
9 Nëntor, 15:13 | **Përditesimi: 9 Nëntor, 15:40**

Share

**Tiranë-** Lëvizte i armatosur në kryeqytet dhe me lëndë narkotike, kapet në flagrancë 40-vjeçari i dyshuar.

Policia e Tiranës bëri me dije se finalizoi operacionin e koduar "Klienti" ditën e sotme (9 Nëntor), nga Sektori për Hetimin e Narkotikëve. Gjatë aksionit u arrestua shtetasi H. Q. (G)., 40 vjeç, banues në Tiranë.

U sekuestrua një armë zjarri pistoletë me krehër dhe municion luftarak dhe sasi lëndë e dyshuar narkotike kokainë.

LEXO EDHE:
**Gugash Magani kërkon të nxjerrë Tiranën nga kriza, trajneri: Me Bylisin si derbi, të 'vrasim' frikën**

> *"Ndërhyrja u krye pas sinjalizimeve dhe informacioneve, bazuar dhe në inteligjencën informative, se në një lokal në rrugën "Halit Bega" ndodhej një shtetas i armatosur", thanë burime zyrtare.*

Gjatë kontrollit fizik të tij, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë dhe sasia e drogës, që u morën si prova materiale, kurse dosja i kaloi prokurorisë për veprime të mëtejshme proceduriale.

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: Tiranë arrestohet droge arme

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

9 Nëntor, 11:21

A ju duken të sigurta kushtet e rrugëve në Shqipëri?

Po Jo Nuk e di

## Lajme të tjera

Tiranë/ Ra në kontakt me rrymën elektrike, humb jetën në spital 56-vjeçari, punonjës i një Shërbimi Privat të Sigurisë Fizike
9 Nëntor, 20:23

Tirana: Epiqendra e re për aktorët e Ballkanit
9 Nëntor, 19:12

Tiranë/ Gjendet një granatë dore në një pallat në ndërtim pranë 'Myslym Shyrit'! Dyshohet e mbetur prej vitesh
9 Nëntor, 15:14

'Grand Park Skyline' kompleksi më i ri rezidencial në hyrje të Liqenit të Tiranës, hotel me 5 yje e qendër komerciale
9 Nëntor, 14:35

Berisha: Mosbindja civile do të vazhdojë, në Parlament për të mbrojtur qytetarët nga vjedhja e buxhetit! Basha stoli e Ramës
9 Nëntor, 14:31

Porositi vrasjen e të 'fortit' të Vlorës për hakmarrje, ekstradohet nga Spanja Leonard Luzi! Si i shpëtoi atentatit Inez Hajrulla në 2023
9 Nëntor, 09:13

Ministri Blendi Gonxhja inspekton punimet në Muzeun e Arteve të Bukura: Hapësira të Reja për Ekspozitat Bashkëkohore dhe për Ruajtjen e Veprave të Artit
8 Nëntor, 17:54

VIDEO/ Dy ndeshjet e Ligës së Kombeve, Sylvinho: Tre lojtarë na vijnë të lënduar, pesë me kartona të verdhë! Duam vendin e parë
8 Nëntor, 11:03

Liga e Kombeve/ Sylvinho publikon 28 'luftëtarët', rikthim për Gjimshitin dhe Baren! Kumbulla dhe Manaj pjesë e listës, jashtë Broja
8 Nëntor, 10:20

Lushnjë/ Bashkëshortja e denoncon për dhunë ndaj saj dhe ngacmim seksual të së bijës 11 vjeçe, arrestohet 39-vjeçari (EMRI)
7 Nëntor, 13:58

Mamurras/ Policia parandalon krimin në familje dhe arreston 40-vjeçarin, i zbulohet dhe një 'depo' armatimi! Gruaja merret në mbrojtje, ja çfarë u sekuestrua
7 Nëntor, 13:09

Abuzimi me çmimet në tregun e grumbullimit të fruta-perimeve, Autoriteti i Konkurrencës hap hetim të thelluar në 5 qarqe! Verifikim periudhës 2023-2024
7 Nëntor, 11:57



© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje